

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Bachelor në Informatikë Ekonomike

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Cikli i studimeve:	Bachelor
Emërtimi i programit të studimit:	Informatikë Ekonomike
Kohëzgjatja e Programit të Studimit:	3 vite (6 semestra)
ECTS:	180 ECTS
Forma e studimit:	Me kohë të plotë
Diploma:	Bachelor në "Informatikë Ekonomike"
Gjuha e zhvillimit të programit:	Shqip

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor ne "Informatikë Ekonomike " synon formimin bazë të profileve bashkëkohore të profesionistëve dhe studiuesve te rinj në fushën e sistemeve informatike dhe ekonomike, të aftë të përballen me sfidat që gjeneron tregu i punës.

Gjate tre viteve te studimit, studenti pajiset me njohuri bazë teorike dhe aplikative që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit dhe në veçanti të sistemeve kompiuterike dhe ekonomisë.

Në përfundim të këtij programi studimi, i diplomuari është në gjendje të analizojë probleme dhe të japë zgjidhje ne terma kompjuterike dhe ekonomike, përmes një larmie instrumentesh.

Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është që studentët të punësohen në pozicione që kanë lidhje me profilin e studimeve përpara përfundimit të vitit të tretë. Gjithashtu, ky program studimi synon të përmbushë edhe objektivat në vijim:

- Studenti të pajiset me njohuritë themelore dhe të avancuara për fushën e studimit.

Njohuritë e fituara nga studenti përfaqësojnë eksperiencat e konsoliduara të fushës dhe të përshtatura edhe për kushtet e teknologjisë dhe ekonomisë shqiptare. Këto njohuri i hapin rrugë mundësisë për të zgjeruar më tej njohuritë gjatë studimeve pasuniversitare për ata që dëshirojnë t'i vazhdojnë këto studime.

- Studenti të jetë i aftë të përshtatet në tregun e punës, duke zënë pozicion pune me ambicie për zhvillimin e karrierës. Studimet japin mundësinë e synimit të pozicioneve të larta në strukturat organizative të subjekteve private apo publike, atje ku kërkohet udhëheqje, drejtim, zbatim dhe vendimmarrje.
- Studenti të njihet me eksperiencat dhe praktikat e aktorëve të teknologjisë se informacionit dhe ekonomisë gjatë viteve të studimit nëpërmjet kryerjes së praktikave apo punësimit në kompanitë me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
- Studenti të jetë konkurrues për vende pune edhe në vende të tjera, në qoftë se ai/ajo dëshiron të punësohet jashtë vendit.

TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT:

	SEMESTRI I PARË		SEMESTRI I DYTË	
	LËNDA	ECTS	LËNDA	ECTS
Viti I	ARKITEKTURË KOMPJUTERI 1	6	MAKROEKONOMI	5
	HYRJE NË TEKNOLOGJI INFORMACIONI	5	BAZAT E KONTABILITETIT	5
	SHKRIM AKADEMIK DHE METODA KËRKIMI	4	MIKROEKONOMI	5
	ALGORITMIKË DHE HYRJE NË PROGRAMIM C++	6	MENAXHIM I BIZNESIT	5
	HYRJE NË EKONOMI	5	MATEMATIKË 1	4
	MENAXHIMI I SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	5	ANGLISHT 1	5
	TOTAL VITI I ECTS			60
	SEMESTRI I PARË		SEMESTRI I DYTË	
	LËNDA	ECTS	LËNDA	ECTS
Viti II	BAZAT E FINANCËS	5	MENAXHIMI I INOVACIONEVE/ETIKE BIZNESI	5
	BAZAT E STATISTIKËS	4	KONTABILITET FINANCIAR	5
	MATEMATIKË 2	4	ËEB DESIGN DHE PROGRAMMING	6
	BAZAT E MARKETINGUT/TREGJET FINANCIARE	5	ORGANIZIM I SISTEMEVE KOMPJUTERIKE	5
	STRUKTURË TË DHËNASH	6	MENAXHIM MARKETINGU/BIZNES NDËRKOMBËTAR	5

	PROGRAMIM I ORIENTUAR NË OBJEKTE - HYRJE NË JAVA	6	ANGLISHT BIZNESI	4
	TOTAL VITI II ECTS			60
Viti III	SEMESTRI I PARË		SEMESTRI I DYTË	
	LËNDA	ECTS	LËNDA	ECTS
	MENAXHIM I RRJETAVE KOMPJUTERIKE	6	STATISTIKË E BIZNESIT	4
	HYRJE NË TEORINË E BAZAVE TË TË DHËNAVE	6	SIGURIA E INFORMACIONIT/ BUSINESS LAW	5
	INTELIGJENCË BIZNESI DHE DATAMINING	6	HYRJE NË MENAXHIM PROJEKTESH / MENAXHIM OPERACIONESH	5
	ARKITEKTURË KOMPJUTERI 2	6	PRAKTIKË DHE ZHVILLIM KARRIERE	7
	HYRJE NË INXHINIERI SOFTWARE-IKE	6	TEMA DIPLOME	9
	TOTAL VITI III ECTS			60
TOTAL ECTS				180

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Një student që diplomohet në Informatikë Ekonomike zotëron një përzierje unike të aftësive në ekonomi, teknologjinë e informacionit dhe analizën e të dhënave.

Këtu mund të përmendim disa mundësi të ndryshme të karrierës si:

- Analist i të Dhënave
- Analist i Inteligjencës së Biznesit
- Analist Financiar
- Analist i Kërkimit të Tregut
- Analist i Rrezikut, etj.

Ato do të fitojnë njohuritë në modelimin ekonomik, analizën e të dhënave dhe parashikimin financiar për të vlerësuar mundësitë e investimeve, rreziqet financiare dhe për të zhvilluar strategji investimi, në menaxhimin e të dhënave, analizën statistikore dhe programimin për të analizuar grupe të mëdha të dhënash dhe për të nxjerrë njohuri për vendimmarrje në industri të ndryshme.

TBU ofron mundësi praktike dhe punësimi gjatë kohës së studimeve

Në TBU studentit i ofrohet mundësia e punësimit që gjatë viteve të studimit. Këto mundësi punësimi dhe praktike mundësohen nga mbështetja që BALFIN Group ofron për TBU si pjesë e tij, e gjithashtu nga kompanitë partnere që TBU bashkëpunon.

TBU bashkëpunon me mbi 150 kompani, zyra ligjore apo institucione financiare ku studentët mund të kryejnë praktika apo të punësohen, si:

- Tirana Bank
- BALFIN IT
- Jumbo
- Neptun
- Balfin Real Estate
- Balfin Construction
- Fashion Group Albania
- ACREM
- Spar Albania
- Raiffeisen Bank
- NOA Financo, etj

MBËSHTETJE DHE LEHTËSI

Bursat e ekselencës, bursat sociale dhe rezervimet e hershme.

Studentët kanë mundësi përfitimi të reduktimit të tarifave për:

1. Bursat e ekselencës

Bursat e ekselencës ofrohen në bazë të mesatares VKM në përfundim të shkollës së mesme. 10 aplikantët për bursë, të renditur të parët në listë sipas datës së rezervimit, përfitojnë bursën sipas skemës.

Skema e bursës:

- VKM +9.5 ofrohet bursa 100%
- VKM +9 ofrohet bursa 75%
- VKM +8 ofrohet bursa 50%

Për të garantuar bursën duhet të kryhet rezervimi duke paguar një pjesë të tarifës administrative prej 20.000 ALL.

2. Bursa Sociale

Bursa sociale do të vlerësohet në bazë të dokumentacionit që do të paraqitet nga kandidati për student në momentin e dorëzimit të dosjes së aplikimit si dhe nga intervista me komisionin e vlerësimit të bursës

Afati për të aplikuar për bursat sociale është data 15 gusht.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Certifikata familjare
- Vërtetim mbi të ardhurat e çdo anëtari të familjes
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të studentit

3. Rezervimet e hershme:

Tirana Business University ofron reduktim të tarifës së studimit për ata studentë që rezervojnë vendin e tyre në një kohë sa më të hershme.

KONTAKTONI

Rruga Rezervat e Shtetit, pranë TEG, Tiranë, Shqipëri

Cel: +355697066966

Web: www.tbu.edu.al

E-mail: admissions@tbu.edu.al